

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

QERSHOR 2015

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Mos e hapni testin dhe mos filloni t'i zgjidhni detyrat pa ju dhënë leje mbikëqyrësi kujdestar.

Testi përmban detyra të cilave duhet t'u përgjigjeni në këtë mënyrë:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë;
- duke shkruar përgjigje të shkurtër ose më të gjatë;
- duke shkëputur pjesë (fjalë, grup fjalësh, fjali ose paragrafë nga tekstet e dhëna);
- duke shkruar tekst në vendin që është paraparë për të;
- duke shkruar ese.

Gjatë dhënies së përgjigjeve duhet të keni kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe zbatimin e normave drejtshkrimore. **Shkruani lexueshëm.** Përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë nëse janë të pallexueshme, janë shkruar me shkronja të mëdha shtypi pa e veçuar shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë, nëse ka paedukatë në të shprehur, nëse në mënyrë të drejtpërdrejtë i drejtoheni vlerësuesit, nëse keni shkarravitur ose keni rrethuar më shumë alternativave.

Si në test, ashtu edhe në fletën e përgjigjeve, shkruani me laps kimik ose stilolaps. Përgjigjet dhe detyrat e shkruara me laps të thjeshtë, vlerësohen me zero (0) pikë. **Pranë çdo pyetjeje dhe detyre janë dhënë pikët për përgjigjen e saktë.**

Së pari duhet të zgjidhni detyrat në test dhe pastaj hartoni punimin me shkrim. Kur ta përfundoni testin, kontrolloni edhe njëherë përgjigjet tuaja. Pasi t'u përgjigjeni pyetjeve në test, përgjigjet e detyrave me zgjedhje të shumëfishtë bartni në fletën e përgjigjeve e cila ndodhet në këtë test. Fletën pastaj kthejeni në test.

Ju dëshirojmë sukses!



FAQE E ZBRAZËT

Duke shfrytëzuar tekstin e dhënë përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Shtatë mrekullitë e botës së lashtë janë një mori veprash arkitektonike të cilat grekët e vjetër, veçanërisht në epokën helene, i konsideronin kryevepra të kreativitetit dhe gjenialitetit njerëzor. Megjithatë, nga këto shtatë mrekulli vetëm kompleksi i piramidave në Giza ekziston sot e kësaj dite.

Tempulli i Artemidës	Në Efes, Turqi
Piramidat e Mëdha	Në Gjiza, Egjipt
Kopshtet e varura të Babilonisë	Në Irak
Kolosi i Rodosit	Në Greqi
Mauzoleu në Halikarnas	Në Bodrum, Turqi
Shtatorja e Zeusit	Në Greqi
Fari i Aleksandrisë	Në Greqi

Përmendja më e vjetër e idesë që të hartohet lista e mrekullive të botës rrjedh nga historiani Herodoti (rreth vitit 450 p.e.s.). Për të parën herë të të shtatë mrekullitë e botës së bashku janë përmendur në epigramin e shkrimtarit fenikas Antipatros nga Sidoni (shekulli II p.e.s.), i cili është autor i udhëpërshkrimit nëpër Mesdheun Lindor të kohës së vet. Grekët këtë listë e kanë quajtur Shtatë atraksionet e vendeve të populluara që patjetër duhet parë. Është e çuditshme që Antipatrosi, edhe pse ishte grek, nuk e kishte futur në këtë përzgjedhje Akropolin. Shtatë mrekullitë e botës sipas të gjitha gjasave janë zgjedhur për arsye se ky numër për grekët e vjetër kishte një simbolikë të numrit magjik. Përshkrimi i shtatë mrekullive të botës ndodhet në traktatin e shekullit VI të erës sonë. Për shtatë mrekullitë e botës (De septem mundi miraculis)

Shtatë mrekullitë e reja të botës ose **Shtatë mrekullitë e botës së re** është një garë ndërkombëtare që është mbajtur në vitin 2007 me nismën e Bernard Veberit, themeluesit të Korporatës së sapo hapur globale, e cila edhe e ka organizuar këtë ngjarje. Veber ka deklaruar se qëllimi i tyre është që të krijojnë shtatë simbole të reja të botës. Gjithashtu, me aksion është dashur të arrihet edhe mbrojtja më e madhe e trashëgimisë arkitektonike dhe ndërtimore të aftësive njerëzore.

Në këtë garë kanë mundur të marrin pjesë objektet që datojnë nga fillimi i botës dhe ato që janë përfunduar deri në vitin 2000, me kusht që të ekzistojnë edhe sot dhe që të jenë në një gjendje të mirë. Gjithkush që ka dashur, ka pasur mundësi që të votojë përmes telefonit, e-mailit, SMS-së ose përmes webfaqes së organizatorit të kësaj ngjarjeje. Praktikisht ka qenë e mundur që i njëjti person të votojë pa kufi – kushti i vetëm ka qenë që çdo herë të votojë nga adresa tjetër e e-mailit ose që të dërgojë SMS nga një telefon tjetër mobil. Nga fillimi i votimit të vitit 2000, nga e gjithë bota kanë arritur gati 200 nominime për mrekulli të reja, por lista është ngushtuar në 21 propozime.

Shpallja e fituesve është mbajtur në Portugali, në Lisbonë, më 7 korrik të vitit 2007. Sipas organizatorëve, rendi sipas të cilit janë shpallur fituesit ka qenë kuturu, dhe nuk ka lidhje me numrin e votave që secili prej tyre ka fituar.

Muri kinez	Në Kinë
Qyteti i vjetër Petra	Në Jordani
Krishti Shpëtimtar	Në Rio-de-Zhanejro, Brazil
Maçu Pikçu	Në Kusko, Peru
Çiçen Ica	Në Jukatan Meksiko
Koloseumi	Në Romë, Itali
Taxh Mahalli	Në Agra, Indi

Nga votimi, megjithatë, menjëherë është distancuar UNESCO, organizata e KB-së për arsim, shkencë dhe kulturë, e cila rregullisht e plotëson Listën e Trashëgimisë Botërore, me vlerësimin se gara pasqyron mendimin e atyre që kanë votuar. Nga kjo rrjedh që votimi nuk është universal, duke pasur parasysh se u është pamundësuar miliona të tjerëve që nuk kanë qasje në internet dhe se lista e kandidatëve është bërë sipas kriterëve që nuk kanë as arsimimin dhe as kriterin shkencor. Vendimin që mos ta mbështesë këtë fushatë UNESCO e ka marrë edhe për atë se mendon që bëhet fjalë për një fushatë mediatike dhe për të mirën personale të Veberit. Gjithashtu kjo organizatë ka shtuar se vlera sentimentale nuk mjafton që një monument të përfshihet në listën e mrekullive.

Disa të tjerë mendojnë se i vetmi qëllim i këtij projekti është përfitimi (votimi me telefona është paguar) edhe pse Bernard Veber pohon se qëllimi i fushatës ka qenë që ta trimërojë diversitetin kulturor me mbështetje, ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve, si dhe të frymëzojë njerëzit që ta vlerësojnë trashëgiminë kulturore. Fondacioni i tij ka kumtuar se do t'i shfrytëzojë 50% të mjeteve të grumbulluara për financimin e restaurimit të trashëgimisë kulturore anë e mbarë botës.

Të tjerët, përsëri, si drejtori i Çiçen Ice-s mendojnë se kjo lloj nisme nxit kompetitivitetin dhe diskriminimin.

Nga Egjipti është kumtuar se ai vend plotësisht e përjashton përfshirjen e piramidave në gara me objekte sikurse është Opera e Sidneit, kurse disa të tjerë madje e kanë karakterizuar projektin si absurd dhe si një promovim të thjeshtë të Bernard Veberit.

Shumë i janë bashkangjitur kritikave që ua ka drejtuar UNESCO, dhe lidhur me këtë që shumë nuk kanë mundur të votojnë për shkak të asaj që nuk kanë qasje në internet; telefon, ose të holla që ta paguajnë votimin. Kësaj i bashkëngjitet edhe fakti i dyshimtë që një person mund të votojë disa herë.

Komentet e pjesëmarrësve:

- 1) Ivon Ortega, guvernatorja e shtetit Jukatan: Populli i lashtë Maja na kanë sjellë fat, por sot duhet ta shfrytëzojmë këtë përparësi të madhe dhe ta përdorim për zhvillimin ekonomik të vendit.
- 2) Daniel Guardado, student nga Brazili: Mendoj se shtatorja e Krishtit duhet të jetë në mes të fituesve. Është shumë e bukur dhe e rëndësishme për qytetin tonë. Rio meriton më shumë se dhunën që hasim çdo ditë e më tepër nëpër rrugët tona.
- 3) Farouk al Hadidi, Ministria e Turizmit të Jordanisë: Më vjen mirë që ndodhemi në mes të fituesve dhe shpresojmë se njerëzit nga të gjithë bota tani do të vijnë edhe më shumë në Jordani që të shohin mrekullinë e re të botës – Petrën.
- 4) Vard Haman, qytetar i Nju Delhit: Edhe unë kam marrë pjesë në votim, mburrem shumë që Taxh Mahalli ka hyrë në mes të mrekullive të botës. Përveç kësaj, Taxhi është simbol i dashurisë së vërtetë.

(Teksti është përgatitur nga burimet e ndryshme)

1. Qëllimi themelor i këtij teksti është:

1. të ofrojë përshkrim të përgjithshëm të shtatë mrekullive të botës
2. të paraqes informacionet jo aq të njohura për trashëgiminë kulturore dhe civilizuese
3. të promovojë Bernard Veberin dhe korporatën e *sapo hapur globale*
4. të tregojë në pikëpamjet e ndryshme për përzgjedhjen e shtatë mrekullive të botës

Rrethojë numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

2. Zgjedhe një argument nga teksti dhe jepe shpjegimin përse UNESCO nuk e ka mbështetur nismën e Veberit.

2 pikë

- 3.** Sqaroje se cila vepër nga lista e shtatë mrekullive botërore të botës së lashtë i plotëson kushtet për pjesëmarrje në garat e shtatë mrekullive botërore të botës së re.

1 pikë

- 4.** Përmendja e parë e shtatë mrekullive të përbashkëta të botës rrjedh nga:

1. shekulli VI p.e.s.
2. shekulli V p.e.s.
3. shekulli II p.e.s.
4. shekulli VI i e.s.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

- 5.** Duke u bazuar në komentet e pjesëmarrësve veçojë arsyen kyçe për shkak të së cilës kanë qenë të dëshirueshme garat.

1 pikë

6. A mund të ketë 7 korriku 2007 domethënie simbolike? Argumentoje përgjigjen tënde.

1 pikë

Lexoje tekstin dhe përgjigju në pyetjet 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Shumë persona të njohur kanë dëshmuar për lidhjen e muzikës me të arriturat e tyre të jashtëzakonshme në fushat e ndryshme. Për shembull, Albert Ajnshtajni, si fëmijë, ka qenë nxënës i dobët. Mësimdhënësi u ka thënë prindërve të tij që ta çregjistrojnë nga shkolla sepse ishte “shumë i trashë që të mësonte”, dhe se për shkollën do të ishte një humbje mjetesh, kohe dhe energjie në arsimimin e tij. Shkolla i kishte propozuar prindërve të tij që Albertit t’i gjejnë një punë fizike. Në vend të kësaj, prindërit i kishin blerë një violinë. Ajnshtajni ishte bërë një violinist i mirë, dhe thoshte se luajtja në violinë ishte sekreti i suksesit të tij shkencor. Miku i tij, G.J.Vithrov, thoshte se Ajnshtajni i zgjidhte problemet matematikore dhe ekuacionet me ndihmën e improvizimit në violinë.

Reagimet në muzikë mund të vërehen lehtë në trupin e njeriut. Muzika klasike nga periudha e barokut e relakson zemrën dhe pulsën, në ritmin e muzikës. Kur trupi të qetësohet dhe të jetë vigjilent, mendja kontrollohet më lehtë. Gjithashtu, muzika e barokut e ul shtypjen e gjakut dhe e përmirëson aftësinë e të mësuarit. Muzika ndikon në amplitudë dhe frekuencë të valëve të trurit, që mund të matet me elektroencefalogram. Muzika gjithashtu ndikon në shpejtësinë e frymëmarrjes dhe në rezistencën elektrike të lëkurës. Bebëzat zgjerohen, rritet shtypja e gjakut dhe pulsi.

Muzika e Mozartit dhe muzika e barokut, me një ritëm prej 60 goditjeve në një minutë, aktivizojnë hemisferën e majtë dhe të djathtë të trurit. Puna e njëkohshme e hemisferës së majtë dhe të djathtë e rritë maksimalisht mësimin dhe mbajtjen e informacioneve. Informacioni i cili studiohet e aktivizon hemisferën e majtë, kurse muzika e aktivizon hemisferën e djathtë. Gjithashtu, aktivitetet që i aktivizojnë të dy hemisferat të njëjtën kohë, sikurse janë luajtja në instrumente ose këndimi, e aftësojnë trurin që më mirë ta përpunojë informacionin.

Sipas pohimeve të Qendrës Amerikane për Hulumtime të Reja në Mësim, potenciali për mësim mund të rritet së paku pesë herë duke shfrytëzuar muzikën me 60 goditje në minutë. Për shembull, grekët e vjetër i këndonin dramën e veta, sepse e dinin se muzika mund t'u ndihmonte që të mbanin mend më lehtë. Psikologu i njohur bullgar, dr. Xhorxh Llozanov, gjeti mënyrën e mësimin më të shpejtë të gjuhës ashtu që u lëshonte nxënësve të vet veprat e caktuara të muzikës klasike nga periudha e barokut. Duke shfrytëzuar sistemin e tij, nxënësit mësonin deri në 1000 fjalë dhe fraza për një ditë. Përveç kësaj, shkalla mesatare e mbajtjes së informacioneve të mësuara ka qenë 92%.

Megjithatë, dëgjimi i muzikës gjatë mësimin nuk garanton mbajtjen mend të informacioneve, por mund ta përmirësojë mësimin. Muzika në sfond vetvetiu nuk është pjesë e procesit të mësimin, mirëpo ajo hyn në të mbajturit mend së bashku me informacionet e mësuara. Thirrja e informacioneve të mësuara është më e mirë atëherë kur gjatë kujtesës shfrytëzohet e njëjta muzikë si ajo që është dëgjuar gjatë mësimin.

(Teksti është përgatitur nga burimet e ndryshme)

7. Ideja themelore e këtij teksti është:

1. të dëshmojë lidhjen e muzikës me të arriturat e jashtëzakonshme të individit
2. të paraqes faktet interesante nga biografia e Albert Ajnshtajnit
3. të tregojë se si arsimimi formal nuk është kusht i suksesit të jetës
4. të tregojë për lidhjen e mundshme në mes të kujtesës dhe muzikës

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

8. Dëgjimi i muzikës barok:

1. relakson trupin dhe rrit shtypjen e gjakut
2. rrit rezistencën elektrike të lëkurës dhe pulsit
3. zvogëlon shtypjen e gjakut dhe relakson zemrën
4. zvogëlon frekuencën e valëve të trurit

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

- 9.** Veçoje karakteristikën kryesore për shkak të së cilës lloji i caktuar i muzikës mund të rris potencialin për mësim?

1 pikë

- 10.** Shënoji aktivitetet të cilat kanë të njëjtin efekt si dëgjimi i muzikës së Mozartit dhe barokut.

1 pikë

- 11.** Titulloje tekstin në mënyrë të tillë që ai ta tërheq sa më shumë vëmendjen e lexuesve.

1 pikë

Duke shfrytëzuar tekstin e dhëna zgjidhi detyrat 12, 13 dhe 14.

Me komshiun je ma shumë se me vëllaun. Të gjindet për çdo gja, po të mos jetë si ai që e jep me dorë dhe e merr me këmbë.

(Nga letërsia politiko-shoqërore)

12. A) Sqaroje domethënien e frazeologjisë e jep me dorë dhe e merr me këmbë.

B) Shkruaje edhe një frazeologjizëm me domethënie të ngjashme.

2 pikë

13. Nga fjalitë e dhëna gjeji gabimet gjuhësore dhe drejtshkrimore dhe përshkruaji ato të përmirësuara mbi vijat e mëposhtme.

2 pikë

14. Cili do të ishte antonim i fjalës komshiu?

1 pikë

15. Cilës periudhë krijuese i takon Hasan Zyko Kamberi?

1. Humanizmit shqiptar
2. Letërsisë shqiptare të shek. XVI-XVII
3. Lëvizjes kulturore dhe letrare të shek. XVIII
4. Rrymës letrare të Bejtexhinjve

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve *1 pikë*

GJERGJ ELEZ ALIJA

(fragment)

Sa ka nisur drita ma zbardhë majet,
n' fushë t' mejdanit trimat konkan dalë,
keq me fjalë trimat sheshojnë po rrekin:
“P’ a prej vorrit, Gjergj, ti konke çue?
Pse me m’ qitë, bre burrë, n’ kët fushë t’ mejdanit?”
Sa mirë trimi i ka përgjegjës Balozit:
“Të lumtë goja, Baloz, mirë po thue,
qe nandë vjet qi kam marrë rrugn’ e vorrit,
pak pa mrrijtë, Baloz, ti m’ ke dredhue:
m’ ke lypë motrën para se mejdanin,
m’ ke lypë berrat para se çobanin,
e jam dredhë n’ kët log për me t’ kallxue
se ne t’ parit’ nji kanu na kanë lanë:
armt’ me dhanë përpara e mandej gjanë,
kurr Balozit motrën mos m’ ia dhanë,
për pa u pre n’ at fushën e mejdanit!
Por shtrëngohu, Baloz, se t’ ka ardhë dita,
se ktu i thonë-o Gjergj Elez Alia!”
E i kanë ba dy gjogat tim për tim
e n’ topuz Balozit e ka shinue:
n’ dy gjujt gjogu Gjergjit te i ka ra,
përmbi kryet topuzi i ka fjurue;
dymbdhjetë pash n’ ledinë u ngul topuzi,
dymbdhetë pash përpjetë si re u çue pluhni.
At’ herë Gjergjit rendi te i ka ardhë,
sa mirë trimi n’ topuz qi ka dredhë,
lik përmbet Balozit te i ka ra.
A’ trandë fusha kur a’ rrxue Balozit.

Mejherë trimi shpatën ma ka xjerrun,
kryet me neje trupit ia ka damun,
zhag për kambet trupin e ka ngrehun,
me gjith at m' nji bunar e ka mbytn.
Të tanë lumën gjaku e ka tërzue,
për tri vjet vendin e ka qelbun.

16. Ku bën pjesë kënga e Gjergj Elez Alisë?

1 pikë

17. Çfarë tregon prania e Balozit në këtë këngë?

1 pikë

18. Për çfarë imazhit flasin fjalët *trim, shpatë, topuz, gjak*?

1. për një debat armësh
2. për një dyluftim të rreptë
3. për një rit të vjetër pagan

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

19. Cili varg sjell rrjedhën e ngadalshme të kohës, përmes simbolikës popullore?

1. qe nandë vjet qi kam marrë rrugn' e vorrit.
2. n' fushë t' mejdanit trimat konkan dalë.
3. por shtrëngohu, Baloz, se t' ka ardhë dita.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

20. Çfarë fjale është anafora në vargjet “Dymbdhetë pash n’ ledinë u ngul topuzi/ dymbdhetë pash përpjetë si re u çue pluhni”?

1. e prejardhur
2. e përbërë
3. e përngjitur

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

21. Në cilën mënyrë është folja në vargun “n’ fushë t’ mejdanit trimat konkan dalë”?

1 pikë

22. Në cilën nga alternativat e mëposhtme kemi rimë emërore?

1. ka xjerrun/ka damun
2. mejdanin/çobanin
3. ka shinue/ka fjurue
4. kanë lanë/ia dhanë

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

Lexoju vargjet dhe përgjigju në pyetjet 23, 24, 25, 26 dhe 27.

SERAFINA TOPIA
(fragment)

Vashë, rritesha plot hire
Tek vatra e prindërve:
Si një pemë e sapoardhur
Hijekëndshme më rritet
Në kopshtin e perandorit
vashë u rrita e zalisur
Nga gjitone e nga të huaja
Si të ndjeja shi e breshër

Që mbi tjegulla kërcisnin,
e të prehesha e dirsur
përkundrejt të korrave,
mua më gëzohej zemra,
si djathit q' e zgjojnë natën
për të vajtur në det,
dhe që sheh nga qerrja e s' ëmës
yjet një mori kandilash
përmi maja lisash lart,
si një botë shumë e largët
që nga dita e tij e shkollës

(Jeronim de Rada)

23. Çka gërshetohet në këtë fragment të zgjedhur?

1 pikë

24. Cila atmosferë mbizotëron në këto vargje?

1 pikë

25. Në cilën vetë zhvillohet rrëfimi në vargjet e mësipërme?

1 pikë

26. Çfarë paraqet poeti përmes figurave letrare në këtë poezi?

1 pikë

27. Ç' funksioni sintaksor kryejnë fjalët e nënvizuara në vargun mua më gëzohej zemra?

1 pikë

28. Pjesa e nënvizuar në fjalinë *Burrat e fshatit shkuan për dru është*:

1 pikë

29. Fjala arsimtar është me:

1. rrokje të hapur
2. rrokje të mbyllur
3. fjalë njërrokëshe

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

30. Më poshtë ke dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250-300 fjalë. Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).
Kij kujdes që në aspektin gjuhësor fjalia të jetë e qartë, e kuptueshme dhe të mos ketë gabime gjuhësore.

1. „RRUGËTIMI I GILGAMESHIT DHE HISTORIA E PËRMBYTJES SË MADHE“

Udhëzime për shkrimin e esesë:

Shkruaj për:

- Lindjen e dëshirës së Gilgameshit për pavdekësi.
- Rrugëtimin e Gilgameshit në shkretëtirë.
- Bisedën e tij me plakun Utnapishtimë dhe historinë e Përmytjes së Madhe.
- Vendimin e perëndisë Beli për shfarosjen e njerëzimit.
- Qëndrimin tënd ndaj atij akti mizor të një perëndie.

- Punën e urtë të hyjnisë së thellësive Ea, që tregoi planin e pashpirt të perëndisë Beli.
- Mendimin tënd për veprën e saj.
- Atë që mori me veten Utnapishtima në barkën e madhe. Reagimin e tij pas përmytjes.
- Zemërimin e hyut Beli pas shpëtimit të barkës dhe ndëshkimin që merr nga perënditë.
- Mësimin moral që marrim nga ngjarja, a duhet çdo gjykim të jetë absolut apo relativ.

Pjesë nga Epi i Gilgameshit "Përmytja e madhe"

Porsa shkëlqeu agimi i mëngjesit,
 të gjitha gjërat nisa t'i bëj gati.(...)
 N'muaj t'Shamshashit¹ barka u ndërtua.
 Çdo gjë që pata në të e ngarkova-
 në të ngarkova argjend edhe ar
 dhe farën e secilit lloj të jetës;
 familjen time, farëfisnin e afërt,
 në barkë të gjithë aherë i vendosa;
 gjedhe² t' mëdha si dhe kafshë të vogla
 aty i solla sin ë zanatlinj
 të çdo mjeshtrie i lashë Brenda të hyjnë.
 E detyrën perendia ma caktoi:
 "Në mbrëmje, kur sunduesit e errësirës
 lëshojnë t 'bjerë shiun fort të tmerrëshëm,
 në barkë hyr e dyert mirë mbylli!"
 Kur erdhi koha, hyjtë e errësirës
 Lëshuan t'bjerë shiun fort të rrebtë.
 Vështroja kohën, ishte mot I tmerrshëm.
 Në barkë hyra dhe dyert I mbylla
 E timonierit barkën ia dorzova.
 Porsa agoi mëngjesi, retë e zeza
 U ngritën lart në qiell si të ishin korba.
 Shpirtërat e këqij të gjithë tërboheshin
 e krejt shkëlqimi shndërrohej në errësirë;
 fërshëllënte jug³, ujërat ushtonin,
 ngrësheshin lart, deri në maje të malit-
 dhe tallazi krejt njerëzit i përpinte.
 Dhe perënditë u tutën nga përmytja,
 të frikësuar në mal t'Anujit⁴ hipën,
 si qentë ulur n'bisht ndër veti shtyhëshin,(...)
 t'përkulur rrinin zotat e vajtonin.

Gjashtë ditë e net porsi rrëke ra shi,
 të shtatën ditë shtërngata zuri t'ndalet,
 sikur pas luftës heshtja mbretëroi,
 der'sa në fashë ⁵ ra ,kurse stuhia
 e kobshme erdh e e krejt u qetësua.
 Kohën kundroja,vërtet kish rënë në fashë,
 në baltë njerëzit ishi shndërruar!
 Kudo e shkretë dukej faqja e tokës.
 E hapa baxhën,⁶ drita m'shkëlqeu n'fytirë
 dhe u plandosa,⁷ndejta shtrirë e qava,
 qava dhe lotët m'rrodhën shi nëpër faqe.
 Hodha shikimin në kënetën ⁸ e largët.
 Të madhe brita. Njerëzit kishin mbaruar!
 Beli ⁹ i madh arrin dhe shikon barkën,
 fort inatoset e n'hyjni zemërohet:
 "Po cila qenie e gjallë paska shpëtuar?
 Asnjë njëri nuk duhej t'mbetej n'jetë-
 ndëshkimit gjygjësor s'duhej t'shmangej."
 Zoti Ninib,¹⁰që është luftëtar,
 e hapi gojën dhe zu të flasë
 dhe t'i drejtohet Belit të fuqishëm:
 "Përpos Easë¹¹ , kush bën punë të urta?
 Çdo gjë kupton, të forte e ka arsyen."
 Hyjnia e thellësive ¹² e hap gojën,
 kështu i thotë Belit të fuqishëm:
 "O hy sundues,ti që je i fortë,
 si munde , vallë, kështu pa menduar,
 përmbytjen kaq të madhe ta shkaktosh?
 Kush bën mëkate,atij le t'i mbesin!
 Dhe krime kush të bëjë,vetë le t'i vuajë!
 Prandaj,ki mendjen,t'gjithë mos i shfaros,
 ndëshko t'këqijtë,t'gjithë mos l zhduk!
 Në vend që ta shkaktoje ti përmbytjen,
 lehtë ke mundur ta sjellësh luanin,
 i kishe pakësuar kështu ti njerëzit:
 në vend të përmbytjes,ka mundur t'vijë
 uria e zezë,token ta pushtojë

Studime gjuhe:

1 Shamashi: Hyj i Diellit, mbrojtës i Gilgameshit dhe Urukut

2 gjedhë: bagëti, lopë, dele, dhi...

3 fërshëllente jug : frynte ere e jugut (që shoqërohet me rrebesh)

4 Anuji: hyj i Qiellit, babai i Hyjneshës së bukurisë, Ishtares

5 në fashë : në qetësi

- 6 baxhë: këtu, dritare e vogël
7 plandosem: bie përtokë me vrik.
8 kënetën: mbas përmbytjes, Toka është kthyer në kënetë
9 Beli: hyj i Tokës, zot hakmarrës, shkaktoi përmbytjen e madhe
10 Ninibi: zoti i Luftës e i shpëtimit
11 Ea: hyui i Diellit e mik i njerëzve
12 hyjnija e thellësive: Ea, Zot i Detit

2. SHOQËRIA DHE INDIVID I NË PASQYRËN E PARAGJYKIMEVE

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Sqaroje domethënien e nocionit të paragjykit/ si mund të përkufizohet?
- Përse të gjithë në disa situata shërbehemi me paragjykime?
- Përmendi paragjykimet më të shpeshta të cilat formohen te individ i nën ndikimin e edukatës familjare dhe autoritetit prindëror.
- Trego për perceptimin negativ të disa komuniteteve të shkaktuara nga paragjykimet.
- Kush është objekt më i shpeshtë i paragjykimeve dhe diskriminimeve në rrethin tënd.
- Përshkruaji si duken disa profesione në pasqyrën e paragjykimeve.
- Sqaroje sa janë disa modele të mendimeve rigide të rrezikshme për shoqërinë dhe individin. Ceki disa shembuj të pasojave ekstreme të paragjykimeve.
- Shprehe mendimin tënd se në çfarë mënyre mund të ndryshohen ose të luftohen stereotipet.

25 pikë

